



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

LIGJ

Nr. 50/2019

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 125/2013,
“PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj, emërtimi “Njësia e Trajtimit të Koncesioneve dhe Partneriteteve Publike Private” zëvendësohet me emërtimin “Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve (ATRAKO)”.

Neni 2

Në nenin 5, pika 1, shkronja “j” shfuqizohet.

Neni 3

Neni 10 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 10

Ministria përgjegjëse për financat

1. Autoriteti i ministrisë përgjegjëse për financat, lidhur me koncesionet/PPP, ushtrohet sipas përcaktimeve në nenet e veçanta të këtij ligji.

2. Ministria përgjegjëse për financat vlerëson dhe miraton paraprakisht të gjitha projektet e koncesionit/(PPP), si dhe çdo ndryshim apo transferim të tyre, nga pikëpamja e implikimeve fiskale, individuale apo në grup për shpenzimet buxhetore, deficitin buxhetor, qëndrueshmërinë e borxhit publik dhe detyrimet kontingjente eventuale. Nëse autoriteti kontraktues nuk e ka shpallur operatorin fitues brenda 2 viteve nga marrja e miratimit nga ministria përgjegjëse për financat, do të dërgojë studimin e fizibilitetit të rishikuar edhe një herë për miratim.

3. Autoritetet kontraktuese janë të detyruara që përpara nënshkrimit të kontratës së koncesionit/PPP me ofertuesin ekonomik të shpallur fitues ta paraqesin atë për vlerësim, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2, të këtij neni, në ministrinë përgjegjëse për financat.

4. Autoritetet kontraktuese i paraqesin, sa herë që kërkohet, por jo më pak se tri herë në vit, ministrit përgjegjës për financat raporte të përmbledhura të monitorimit të zbatimit të kontratave të koncesionit/PPP me argumentet dhe shpjegimet përkatëse. Forma, përmbajtja dhe afatet e raporteve të monitorimit përcaktohen me udhëzim të veçantë të ministrit përgjegjës për financat.

5. Bazuar në raportet e monitorimit, të specifikuara në pikën 4, të këtij neni, ministria përgjegjëse për financat mund t'u rekomandojë autoriteteve kontraktuese marrjen e masave për përmirësimin e performancës në ofrimin e shërbimeve dhe punëve publike, objekt i këtyre kontratave, si dhe për minimizimin apo eliminimin e risqeve të drejtpërdrejta e të tërthorta që ndikojnë në buxhetin e shtetit.

6. Autoritetet kontraktuese, brenda gjashtëmuajorit të parë të çdo viti, dërgojnë në ministrinë përgjegjëse për financat pasqyrat financiare vjetore të audituara dhe të konfirmuara nga autoritetet tatimore të vitit paraardhës të shoqërive koncesionare.

7. Ministri përgjegjës për financat përgatit një raport vjetor të përmbledhur mbi ecurinë e kontratave aktive të koncesionit/PPP, si aneks i raportit vjetor të zbatimit të buxhetit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor.

8. Këshilli i Ministrave miraton rregullat për vlerësimin dhe miratimin e projekteve, sipas pikës 2 të këtij neni.”.

Neni 4

Në nenin 11, shkronja “b” ndryshohet si më poshtë:

“b) përjashton një operator ekonomik, sipas dispozitave të ligjit të prokurimit publik, nga përfitimi i kontratave publike.”.

Neni 5

Në nenin 12 bëhen shtesat dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Në pikën 3, pas shkronjës “c” shtohen shkronjat “ç”, “d”, “dh” dhe “e” me këtë përmbajtje:

“ç) i propozon për miratim Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP kërkesat e autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar në hartimin e studimeve të fizibilitetit të projekteve të koncesionit/PPP;

d) i propozon për miratim Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP kërkesat e ministrisë përgjegjëse për financat për mbështetje me ekspertizë të specializuar për kryerjen e oponencës së studimeve të fizibilitetit të projekteve të koncesionit/PPP;

dh) i propozon për miratim Komitetit të Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP kërkesat e autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar për kryerjen e oponencës së propozimeve të pakërkuara;

e) kryen procedurat e përzgjedhjes së konsulentëve të jashtëm, në përputhje me procedurat e prokurimit publik.”.

2. Pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve siguron të ardhura nga shërbimet që ofron si dhe nga donatorë vendas apo të huaj.”.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Mënyra e organizimit dhe funksionimit si dhe procedurat e niveli i tarifave të shërbimeve që do të ofrohen nga Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 6

Pas nenit 12 shtohet neni 12/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 12/1

Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP

1. Për përzgjedhjen e projekteve të koncesionit/PPP, të cilat do të mbështeten me ekspertizë të specializuar në hartimin e studimit të fizibilitetit dhe/ose në kryerjen e oponencës së tyre, krijohet Komiteti i Përzgjedhjes së Projekteve të Koncesionit/PPP, organ administrativ kolegjal, i cili kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe në përbërje të tij ka këta anëtarë:

- a) ministrin përgjegjës për financat;
- b) ministrin përgjegjës për infrastrukturën;
- c) ministrin përgjegjës për energjinë dhe industrinë;
- ç) ministrin përgjegjës për zhvillimin urban;
- d) ministrin përgjegjës për mjedisin.

2. Komiteti fton, rast pas rasti, pa të drejtë vote, përfaqësues nga bota akademike, si dhe titullarët e autoritetit kontraktues, të cilët kanë fushë të veprimtarisë objektin e projektit të koncesionit/PPP, për të argumentuar kërkesën e tyre.

3. Komiteti shqyrton dhe miraton kërkesat e autoriteteve kontraktuese për mbështetjen me ekspertizë të specializuar për hartimin e studimit të fizibilitetit të projekteve të mundshme të koncesionit/PPP.

4. Këshilli i Ministrave miraton me vendim rregulloren për mënyrën e funksionimit të tij dhe kriteret për vlerësimin e kërkesave të autoriteteve kontraktuese për mbështetje me ekspertizë të specializuar në hartimin e studimit të fizibilitetit të projekteve të mundshme të koncesionit/PPP.

5. Rolin e Sekretariatit të Komitetit e kryen Agjencia e Trajtimit të Koncesioneve, e cila mundëson të gjithë mbështetjen e nevojshme për mbarëvajtjen e mbledhjeve.”.

Neni 7

Në nenin 16 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pas pikës 2 shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

“2/1. Në rast se autoriteti kontraktues kërkon mbështetjen me ekspertizë të specializuar për hartimin e studimit të fizibilitetit dhe/ose oponencën e projekteve të koncesionit/PPP, i drejtohet me kërkesë të argumentuar Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve. Kërkesa duhet të përmbajë argumente mbi përshtatshmërinë, nevojën dhe elemente të leverdishmërisë së dhënies së këtij projekti me koncesion/PPP, si dhe referencat për ekspertizën e duhur. Në çdo rast, për

projektet me vlerë mbi 100 000 000 euro, autoritetet kontraktuese i drejtohen Komitetit për Përzgjedhjen e Projekteve të Koncesionit/PPP për mbështetje me ekspertizë.”.

2. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Këshilli i Ministrave miraton rregulla më të hollësishme në zbatim të këtij neni”.

Neni 8

Në nenin 17 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 2, shkronja “d” ndryshohet si më poshtë:

“d) operatorët ekonomikë nëpërmjet propozimeve të pakërkuara vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror.”.

2. Pika 4 shfuqizohet.

Neni 9

Në nenin 19, pas pikës 5 shtohen pikat 6 e 7 me këtë përmbajtje:

“6. Përpara shpalljes së procedurës së dhënies me koncesion/PPP, autoritetet kontraktuese dërgojnë studimin e fizibilitetit, si dhe çdo ndryshim të mëtejshëm të tij, në ministrinë përgjegjëse për financat. Ministria përgjegjëse për financat e vlerëson dhe miraton studimin në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2, të nenit 10, të ligjit.

7. Për qëllime të zbatimit të pikës 6, të këtij neni, autoriteti kontraktues duhet të dorëzojë studimin e fizibilitetit të objektit dhe draftkontratën pranë ministrisë përgjegjëse për financat.”.

Neni 10

Neni 25 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 25

Propozimet e pakërkuara

1. Autoriteti kontraktues autorizohet të shqyrtojë dhe të pranojë propozimet e pakërkuara vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose ofrimin e shërbimeve në porte, aeroporte, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike, energjisë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror, në përputhje me procedurat e përcaktuara në këtë nen, me kusht që këto propozime të mos kenë të bëjnë me një projekt, për të cilin procedurat e përzgjedhjes kanë nisur apo janë shpallur.

2. Nëse propozimi i pakërkuar konsiderohet i pranueshëm, pas vlerësimit paraprak, autoriteti kontraktues mund të ndërmarrë veprimet për dhënien e koncesionit/PPP. Nuk do të pranohen propozimet e pakërkuara, të shoqëruara me studim në formë minimale.

3. Kur procedura e dhënies së koncesionit/PPP e nisur mbi një propozim të pakërkuar finalizohet me nënshkrimin e kontratës, autoriteti kontraktues kompenson shpenzimet e bëra nga propozuesi për përgatitjen e studimit të fizibilitetit, vetëm nëse propozuesi i pakërkuar nuk është ofertuesi fitues.

4. Shuma e kompensimit për propozimin e pakërkuar nuk mund të jetë më e lartë se 1 % e vlerës së investimit. Vlera e përcaktuar e kompensimit do të publikohet në dokumentet e procedurës konkurruese dhe do të paguhet nga ofertuesi i shpallur fitues përpara nënshkrimit të kontratës.

5. Këshilli i Ministrave përcakton rregullat për vlerësimin e pranueshmërisë, përmbajtjen dhe trajtimin e propozimeve të pakërkuara dhe mënyrën e llogaritjes së shumës së kompensimit.”.

Neni 11

Në nenin 26 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Autoriteti kontraktues fton ofertuesin më të suksesshëm për lidhjen e kontratës, pas botimit të njoftimit të fituesit, në Buletinin e Njoftimeve Publike.”.

2. Pika 4 shfuqizohet.

3. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Pas negociimit të kontratës me operatorin e shpallur fitues dhe përpara nënshkrimit të saj, autoriteti kontraktues e dërgon projektkontratën për vlerësim përfundimtar, në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2, të nenit 10, të ligjit, në ministrinë përgjegjëse për financat.”.

4. Pas pikës 8 shtohet pika 9 me këtë përmbajtje:

“9. Kontratat e koncesionit/PPP me mbështetje financiare dhe që marrin përsipër risqe fiskale, pas nënshkrimit nga palët dhe vetëm pas marrjes së vlerësimit përfundimtar nga ministria përgjegjëse për financat, në përputhje me pikën 4/1 të këtij neni, dërgohen për miratim në Këshillin e Ministrave. Llojet dhe natyra e risqeve fiskale të mundshme përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 12

Në nenin 28, pika 1 ndryshohet si më poshtë:

“1. Para nënshkrimit ose hyrjes në fuqi të kontratës, autoriteti kontraktues merr nga ofertuesi më i suksesshëm garancitë e kërkuara për realizimin e kontratës dhe instrumentet e sigurisë si kompensim për dëmin që mund të shkaktohet si pasojë e dështimit të koncesionarëve/partnerëve privatë për të përmbushur detyrimet e parashikuara në kontratë (premtim për pagesë, garanci bankare, garanci të korporatës, kambiale etj.). Sigurimi i kontratës do të jetë deri në 5 % të vlerës së kontratës dhe përcaktohet në dokumentet e tenderit. Kjo masë mund të reduktohet në mënyrë përpjesëtimore gjatë ekzekutimit të kontratës, por, në asnjë rast, gjatë kohëzgjatjes së saj, nuk mund të jetë më e vogël se 25 % e vlerës fillestare të sigurimit.”.

Neni 13

Në nenin 29 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 1, pas fjalëve “në fushën e shëndetësisë” shtohen fjalët “dhe në fushën e sportit”.

2. Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“6. Kur tarifa koncesionare nuk paguhet në përputhje me përcaktimet e këtij neni, autoriteti kontraktues njofton ministrin përgjegjës për financat, urdhri i të cilit për arkëtimin e tarifës përbën titull ekzekutiv për bankat e nivelit të dytë ku ndodhet llogaria bankare e shoqërisë koncesionare që vihet në ekzekutim nga përbaruesi gjyqësor.”.

Neni 14

Në nenin 31, pikat 6 dhe 7 ndryshohen si më poshtë:

“6. Për të gjitha ndryshimet e planifikuara të kontratës, autoriteti kontraktues kërkon një miratim paraprak nga ministria përgjegjëse për financat, e cila i vlerëson në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2, të nenit 10, të ligjit.

7. Çdo ndryshim i kontratës së koncesionit/PPP me mbështetje financiare dhe që merr përsipër risqe fiskale, vetëm pas marrjes së miratimit paraprak nga ministria përgjegjëse për financat, në përputhje me pikën 6, të këtij neni, dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave nga autoritetet kontraktuese.”.

Neni 15

Në nenin 32, pikat 4 e 5 ndryshohen si më poshtë:

“4. Për të gjitha transferimet e planifikuara të kontratës, autoriteti kontraktues kërkon një miratim paraprak nga ministria përgjegjëse për financat, e cila i vlerëson në përputhje me kriteret e përcaktuara në pikën 2, të nenit 10, të ligjit.

5. Çdo transferim i kontratës së koncesionit/PPP me mbështetje financiare dhe që merr përsipër risqe fiskale, vetëm pas marrjes së miratimit paraprak nga ministria përgjegjëse për financat, në përputhje me pikën 4, të këtij neni, dërgohet për miratim në Këshillin e Ministrave nga autoritetet kontraktuese.”.

Neni 16

Neni 42 shfuqizohet.

Neni 17

Dispozita të fundit

1. Autoriteti kontraktues vazhdon procedurat për shqyrtimin dhe dhënien me koncesion vetëm për propozimet e pakërkuara, të paraqitura para datës 1 tetor 2019, për të cilat është krijuar nga autoriteti kontraktues komisioni i koncesionit/PPP.

2. Këshilli i Ministrave, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, nxjerr aktet nënligjore, të përcaktuara në nenet 3, 5, 6, 7 dhe 10 të këtij ligji.

Neni 18

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare, me përjashtim të nenit 2, nenit 8, pika 1, dhe nenit 10 të këtij ligji, të cilët hyjnë në fuqi më 1 tetor 2019.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 18.7.2019

